


KONTROLLI I SHTETIT PËR INSTITUCIONE MË TË MIRA

nga Evis KRESHPAJ – Drejtore Drejtorie, Ina SOKOLI – Audituese e Parë,
botuar në gazetën “Koha Jonë”, më 01 prill 2015.



Hendeku që ekziston midis realizimit të programit të qeverisë e financiar nga buxheti i miratuar nga Kuvendi, realizimi i politikave të ekzekutivit për përmbushjen e interesit publik dhe realizimit të misionit të mirëqeverisjes së financave publike ekziston në shumë vende të zhvilluara. Është KLSH por jo i vetëm, si një institucion i pavarur, depolitizuar, transparent dhe në mbrojtje të interesit publik i cili luan një rol të rëndësishëm në përgjegjësinë që duhet të këtë qeverisja në përmbushjen e mandatit të saj politike.

KLSH përballlet me ndryshimet në politikat e drejtimit të financave publike kur auditon mbi shpenzimet dhe performancën e veprimtarisë së institucioneve publike dhe ndërmjet dhënies së rekomandimeve bëhet pjesë

e zinxhirit të ndryshimit. Sipas fjalës përshëndetëse në Konferencën e dytë Shkencore të KLSH të zhvilluar në dhjetor 2013, z. Robert Gielisse, Drejtor i Njësisë së DG-Budget, nënvizoi përgjegjësinë menaxheriale si një element kyç për qeverisjen e mirë. Sipas tij: *“Përgjegjësia Menaxheriale ka të bëjë me mënyrën se si është duke u përdorur autoriteti për të arritur objektivat. Transparenca e autoritetit mund të jetë e jashtme, që do të thotë e hapur për shqyrtimin e publikut dhe përgjegjësi e brendshme, e cila ka të bëjë me transparencën në lidhje me mënyrën sesi janë arritur objektivat.”*

Profilizimi i KLSH si një institucion evropian modern i auditimit suprem publik i cili e bazon tërësisht aktivitetin e tij në standardet e INTOSAI-t dhe moton e kësaj organizate *“Experientia mutua Omnibus prodest”* (Nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë), duke i dhënë një rëndësi të veçantë zbatimit të ISSAI 1, Deklarata e Limës, neni 15. Shkëmbimi i eksperiencave duke krijuar një bashkëpunim të gjerë dhe të ngushtë me qytetarët dhe shoqërinë civile, me qeverinë dhe me të gjithë partnerët e tjerë kombëtar dhe ndërkombëtar.

Vlen të theksojmë marrëdhënien e KLSH me Kuvendin gjatë 2014 e cila kanë qenë efektive dhe ka ndikuar në përgjegjësinë e përbashkët në forcimin e llogaridhënies në menaxhimin financiar dhe qeverisjen e mirë. Kjo e faktuar dhe në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë të qershorit 2014 ku citohet: *“Në ushtrimin të funksionit kushtetues të kontrollit parlamentar, Kuvendi i Shqipërisë mbështet ndërveprimin gjithëpërfshirës të të gjitha institucioneve ligj zbatuese, lidhur me detyrueshmërinë e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”*.

Gjatë periudhës 2012-2015 KLSH ka nënshkruar 9 marrëveshje me institucionet homologe ndërkombëtare (Austrië, Kroacië, Polonië, Sllovenië, etj.), 6 marrëveshje me institucionet publike shqiptare dhe 17 marrëveshje me organizata jofitimprurëse, ku së fundmi ajo e nënshkruar në datën 19.02.2015 me Komitetin Shqiptar të Helsinkit. Përbushja efektive e marrëveshjeve ka dhënë kontributin në realizimin e qëllimit si institucion kushtetues dhe në realizimin e objektivit të ekzistencës për dhënien e sigurisë së arsyeshme në lidhje me nivelin e realizimit të politikave në përbushje të interesave të publikut.




Në kuadër të asistencës për Shqipërinë dhe në zbatim të Instrumentit të Parazgjerimit IPA 2013, KLSH ka fituar nga Bashkimi Evropian financimin e projektit “*Forcimin e*

kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm” e cila padiskutim do të ndihmojë në ecjen në rrugë të sigurt në modernizimin dhe realizimin e auditiveve në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe me praktikat më të mira të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Synimi i kësaj marrëveshjeve është rritja e cilësisë së punës së stafit të KLSH-së, sensibilizimi i opinionit publik në thellimin e luftës kundër korrupsionit në parandalimin e tij dhe të keqadministrimit të fondeve publike, të të mirave publike dhe rritja e transparencës në lidhje me veprimtarinë administrative të institucioneve publike. Marrëveshjet e bashkëpunimit kanë

si qëllim lehtësimin, bashkëpunimin dhe bashkërendimin e palëve duke thjeshtuar komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave që lidhen me ato fusha ku interesi është i përbashkët. Bashkëpunimi midis palëve vendoset duke respektuar me rigorozitet parimet e mirëkuptimit, reciprocitetit dhe pavarësinë e palëve.

Produkt i përmbushjes së këtyre marrëveshjeve janë trajnimet, takimet konsultative, tryezat e rrumbullakëta, Workshop-e, seminare, etj. I përkthyer me shifra konkrete çdo anëtar i stafit në KLSH është trajnuar gjatë 2014 me 26 ditë për person dhe për më tepër, kjo shifër flet për një indeks që është 11 herë më e lartë se gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011, apo 9 herë më të lartë referuar të tre viteve të marra së bashku (2012-2014). Rritja jo vetëm e numrit të trajnimeve por edhe i cilësisë kanë dhënë ndikimin gjatë veprimtarisë audituese në vitin 2014, ku faktehet një rritje e numrit të auditimeve financiare me 10 për qind dhe atë të performancës me 33 për qind, krahasuar kjo me vitin 2013.



Roli i KLSH-së në morinë e institucioneve publike qëndron në auditimin e zbatimit të politikave të miratuara të qeverisë dhe në diagnostikimit dhe prezantimin e problemeve potenciale që lidhen me shpenzimin e parave të

taksapaguesve shqiptarë.

Për më tepër raportet e auditimit të KLSH-së janë burimi i vetëm, i pavarur i informacionit që lidhet me zbatimin e buxhetit dhe si i tillë është burimi i vetëm i informacionit të besueshëm në lidhje me efektivitetin dhe eficiencën e qeverisjes që është në dispozicion të publikut.



Në veprimtarinë e Kontrollit të Lartë i Shtetit ka ndikuar dhe përmbushja efektive e këtyre marrëveshjeve duke dhënë ndikim në punën audituese. KLSH ka realizuar dhe tejkaluar objektivat vjetore të veprimtarisë funksionale më konkretisht: nga KLSH janë evaduar 160 auditime, në krahasim me 153 auditimeve financiare të kryera në 2013, ose 4.6 për qind më shumë.

Në termat e dobisë së rezultateve të auditimit, për çdo lekë të shpenzuar nga ana e KLSH-së në vitin 2014, institucioni ka kërkuar rimbursimi e buxhetit të shtetit me 38 lekë. Në punën tonë të auditimit ne kemi synuar që me anën e rekomandimeve të kemi ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e statusit të subjekteve të audituara në funksion të menaxhimit të mirë të fondeve në dispozicion, por gjithashtu dhe në mirë qeverisjen e financave publike.



Analiza vjetore e Kontrollit të Lartë të Shtetit jo pa qëllim u zhvillua në mjediset e një prej universiteteve publike të vendit që mban emrin e burrit të madh të kombit shqiptar, Ismail Qemalit për vetë faktin që mjediset akademike gjenerojnë ide përfaqëse dhe metodika pune shumë me vlerë për auditimin suprem kombëtar, kjo dhe në zbatim të standardeve të INTOSAI-t (ISSAI1, deklarata e Limës, neni 12, Opinioni i Ekspertëve dhe e drejta për konsultim, Bashkëpunimi me ambientet akademike).

Por në përmbushjen e misionit të saj KLSH ka konstatuar se nuk është e mjaftueshme vetëm identifikimi i parregullsive dhe shkeljeve, mundësisë për mashtrim apo menaxhimit të varfër të të ardhurave publike nga institucionet publike por është e domosdoshme që ndërmjet zbatimit të rekomandimeve të bëhet e mundur identifikimi dhe aplikimi i procedurave të përmirësuara në përputhje me bazën ligjore nga institucionet e ekzekutivi, në mënyrë që të përmirësohet veprimtaria institucionale. Sundimi i ligjit dhe demokracia janë esenciale për një auditim të pavarur të qeverisë dhe janë kolonat ku mbështeten standardet e INTOSAI-t. KLSH

funksionon mbi bazën e një parimi themelor, atë të interesit publik i cili është prevalent ndaj çdo parimi tjetër.

Shkëmbimi ndërkombëtar i eksperiencave, bashkëpunimi me institucionet homologe ndërkombëtare (Austrië, Kroacië, Polonië Sllovenië, etj.), me institucionet publike shqiptare dhe me organizata jofitimprurëse është një mjet efektiv për të ndihmuar Kontrollin e Lartë të Shtetit për të përmbushur misionin e tij kushtetues. Ky bashkëpunim ndërkombëtar dhe kombëtar është i një rëndësie të veçantë për krijimin dhe zhvillimin e një terminologjie uniforme të auditimit të qeverisjes, që bazohet në sundimin dhe zbatimin e ligjit.